



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVO BAR ASSOCIATION

Republika e Kosovës / Republika Kosova
ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
VENDIMI ESHTE I FORMËS SË PRERË
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
Data: 18.06. 2019 vit. god.
Punëtori i autorizuar
Ovlašteni radnik
[Signature]

V. KD. - Nr.23-8/18

KOMISIONI DISIPLINOR I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS

Kolegji Disiplinor i OAK-së në përbërje nga: Xhelal Hasani - Kryesues, Naim Aliu dhe Musa Dragusha – anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Ma.sc.Vjollca Ajeti, Administratore e Zyrës Disiplinore – Procesmbajtëse, në mungesë të Prokurorit Disiplinor të OAK-së, F. Sh., në mungesë të të paraqiturit av. M. Sh., në prezencë të ushtruesit të fletparaqitjes disiplinore z. B. K., duke vendosur në çështjen disiplinore kundër të paraqiturit av. M. Sh. me adresën Rr. “ M. K. nr. “ në Prishtinë, në bazë të Propozimit të Prokurorit Disiplinor të OAK-së me nr.97- 3/2018 të datës 12.11.2018, sipas fletëparaqitjes së ushtruar nga Z. B. K., konform neneve 27, 28, 29, 30 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të OAK-së, lidhur me nenin 118 par. 3 lidhur me nenin 121 të Statutit të OAK-së dhe nenin 6, 8, 52, dhe 58 të Kodit të Etikës Profesionale për Avokatë, në seancën kryesore dëgjimore të mbajtur më 31.05.2019 mori këtë:

VENDIM

- I. **PUSHOHET** procedura disiplinore ndaj të paraqiturit avokat M. Sh. me seli te zyrës në Prishtinë sipas Propozimit të Prokurorit Disiplinor të OAK-së nr. 97-3/2018, dhe fletëparaqitjes së ushtruar nga z. B. K. për shkak të shkeljeve disiplinore nga neni 118 par. 3, lidhur me nenin 121 të Statutit të OAK-së dhe neneve 6, 8, 52 e 58 të Kodit të Etikës Profesionale për Avokat pasi që prokurori disiplinor është tërhequr nga raporti me nr. 97-3/2018 i dt:12.11.2018, për shkak të aritjes së prashkrimit, konfrom neni 56 të Ligjit për Avokatinë.
- II. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të buxhetit të OAK-së.

Arsyetimi

Parashtruesi i fletëparaqitjes dhe pretendimet e parashtruesit

Zyra e Prokurorit Disiplinor të OAK-së ka pranuar fletparaqitjen disiplinore nga z.B. K. me pretendimet se avokati M. Sh. ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Avokat dhe shkelje të Statutit të OAK-së.

Zyra Disiplinore e Odës së Avokatëve të Kosovës
Rr. Bedri Pejani Nr.31, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 244 586; 038 243 717; Fax: 038 244 586

Njoftimi i i Prokurorit Disiplinor të Odës së Avokatëve të Kosovës

Pas pranimit të fletëparaqitjes së theksuar më lartë Zyra e Prokurorit Disiplinor të njejtën e ka shqyrtuar dhe ka gjetur se ekzistojnë dyshimet se i paraqituri av. M. Sh. ka bërë shkelje të normativës së OAK-së, andaj Prokurori Disiplinor i ka filluar hetimet dhe pas përfundimit të hetimeve ka përgaditur raportin e hetimeve të cilin i'a ka dërguar Zyres Disiplinore të OAK-së për Komisionin Disiplinor të OAK-së, me rekomandim që kundër av. M. Sh. të zhvillohet procedura disiplinore, dhe të njëjtit t'i shqiptohet masë disiplinore për shkeljet disiplinore nga neni 118. par 3 lidhur me nenin 121 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 6, 8, 52 dhe 58 të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit.

Komisioni Disiplinor i Odës së Avokatëve të Kosovës

Komisioni Disiplinor i Odës së Avokatëve të Kosovës, konform 21 par.1, nën par.1.2, të Rregullores mbi Procedurën Disiplinore është përgjegjës për miratimin apo refuzimin e rekomandimit të zyres së Prokurorit Disiplinor të OAK-së lidhur me atë se a ekziston apo jo arsyeja e bazuar për shqyrtimin e çështjes.

Vendimi i Komisioni Disiplinor të OAK-së në shqyrtimin Fillestar

Komisioni Disiplinor në seancën e mbajtur me shqyrtim fillestar me datën 03.12.2018 e ka aprovuar rekomandimin nga raporti i Prokurorit Disiplinor të OAK-së dhe ka vendosur që të zhvillohet Procedura Disiplinore kundër av. M. Sh.

Kolegji Disiplinor i OAK-së e ka caktuar dhe mbajtur seancën kryesore dëgjimore më datën 21.01.2019, në prezencë të Prokurorit Disiplinor të OAK-së në prezencë të av. M. Sh. në prezencë të ushtruesit të fletëparaqitjes disiplinore në të cilën seancë i paraqituri av. M. Sh. ka pas vërejtje dhe ka kërkuar përjashtimin e të Prokurorit Disiplinor të OAK-së me arsyetimin se tani ai është emëruar drejtor ekzekutiv i OAK-së dhe se nuk mund të ushtroj edhe funksionin e Prokurorit Disiplinor të OAK-së për shkak të konfliktit të interesit. Duke vepruar sipas kërkesës së të paraqiturit av. M. Sh. kolegji disiplinor ka ndërprerë seancën dhe me datën 24.01.2019 me kërkesën me shkrim i është drejtuar Këshillit Drejtues të OAK-së për sqarim lidhur me pretendimet e avokatit M. Sh.

Këshilli Drejtues i OAK-së duke vepruar sipas kërkesës sime si kryesues i panelit disiplinor ka marrë vendimin me nr.108-1/2019 të datës 27.04.2019 me të cilin vendim sipas arsyetimit të këtij vendimi Prokurori Disiplinor i OAK-së ka të drejtë të ushtroj edhe funksionin e Prokurorit Disiplinor deri në zgjidhjen e prokurorit të ri sipas vendimit të Këshillit Drejtues të OAK-së me nr. 41/2019 të dates 14.01.2019.

Pas marjes se vendmit të lartcekur nga ana e Këshillit Drejtues të OAK-së unë si kryesues kam caktuar seancën kryesore dëgjimore për datën 31.05.2019.


Zyra Disiplinore e Odës së Avokatëve të Kosovës
Rr. Bedri Pejani Nr.31, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 244 586; 038 243 717; Fax: 038 244 586

Kolegji disiplinor ka pranuar parashtrësën nga Zyra e Prokurorit Disiplinor me nr. 23-7/19, të datës 30.05.2019 me të cilën parashtrësë njofton kolegjin disiplinor se tërhiqet nga raporti 97-3/2018, i datës 12.11.2018, për shkak të aritjes së parashkrimit konform nenit 56 të Ligjit Për Avokatinë, me arsyetimin se shkeljet e pretenduara kanë qenë ndërrmar me 14.02.2018, e që reflekton që në bazë të Ligjit për Avokatinë nenit 56, me datën 14.02.2019 ka arritë afati i parashkrimit absolut.


Duke u bazuar në arsyerat e theksuara më lartë Kolegji Disiplinor në seancën e mbajtur me 31.05.2019 morri vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji Disiplinor i Odës së Avokatëve të Kosovës
V. KD. - Nr.23-8/18 të dt: 31.05.2019.

Procesëmbajtësja:
Ma.sc.Vjollca Ajeti



Kryesuesi i Kolegjit Disiplinor:
av.Xhelal Hasani



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në afat prej 8 ditësh pranë Komisionit të Ankesave të OAK-së përmes këtij Komisioni.